



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0022173-3/24, dt. 08.04.2024

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 9, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 08/L-260 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (GZ Nr. 26/dhjetor 2023,); neneve 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 08.04.2024, pasi shqyrtoi Kërkesën Nr.02-400/01-0019710/24 dt. 18.03.2024 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023 në buxhetin e vitit 2024, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0019837-2/24 dt. 28.03.2024), sjell këtë:

VENDIM

Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023 në buxhetin e vitit 2024 (pjesa e tejkalimit të planit)

- MIRATOHET Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake (pjesa e tejkalimit të planit) nga viti 2023 në buxhetin e vitit 2024.
- Shuma e mjeteve të bartura sipas pikës 1 të këtij Vendimi është 329,527.56 €.
 - Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 44,262.91€ destinohet për kategoritë ekonomike Mallra dhe Shërbime në nënprogramin - Menaxhimi i katastrofave natyrore (18466).
 - Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 180,000.00€ destinohet për kategoritë ekonomike të shpenzimeve Subvencione dhe transfere në nënprogramet:
 - Integritime Evropiane (16562), në vlerë 10,000.00 €,
 - Bujqësia (47022), në vlerë 30,000.00 €,
 - Pylltaria dhe Inspekcioni (47102), në vlerë 20,000.00 €,
 - Shërbimet kulturore (85022), në vlerë 120,000.00 €,
 - Nga Shuma e cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, shuma prej 105,264.65 € destinohet për kategoritë ekonomike të shpenzimeve kapitale në nënprogramet:
 - Zhvillimi Ekonomik (48022) në vlerë prej 90,000.00 €,
 - Shërbimet kulturore (85022), në vlerë 15,264.65 € .
- Pjesë e këtij Vendimi është tabela Nr. 1. Shpërndarja sipas programeve buxhetore dhe tabela Nr. 4.2 Lisa e projekteve kapitale.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
DBF



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

BARTJA E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2023 NË VITIN 2024

Tabela 1. Shpërndarja sipas Programeve Buxhetore

Nr	Nën Kodet	Kodi Funkcional	Programet / Nën programet	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Investimet Kapitale	Totali
1	16322	0133	Administrata dhe Personeli	-	-	-	-	-	-
2	16562	0133	Integrimet Evropiane	-	-	-	10,000.00	-	10,000.00
3	17522	0112	Buxhetimi	-	-	-	-	-	-
4	18466	0320	Menaxhimi i katastrofave natyrore	-	44,262.91	-	-	-	44,262.91
5	47022	0421	Bujqësia	-	-	-	30,000.00	-	30,000.00
6	47102	0422	Pylltaria dhe Inspeksioni	-	-	-	20,000.00	-	20,000.00
7	48022	0411	Zhvillimi Ekonomik	-	-	-	-	90,000.00	90,000.00
8	66115	0620	Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ	-	-	-	-	-	-
9	73031	0760	Administrata e Shëndetsisë	-	-	-	-	-	-
10	74300	0721	Shërbimet e shëndetsisë primare	-	-	-	-	-	-
11	75606	1040	Shërbimet Sociale	-	-	-	-	-	-
12	85022	0820	Shërbimet Kulturore	-	-	-	120,000.00	15,264.65	135,264.65
				-	44,262.91	-	180,000.00	105,264.65	329,527.56

Per bartje 329,527.56

Ndryshimi

Tabela 4.2. Lista e projekteve kapitale


Kodi I Projektit	Nën Kodet	Kodi Funkcional	Programet Buxhetore	Emri I projektit	Totali
52963	48022	0411	Zhvillimi Ekonomik	Asfaltimi i rrugës Agim Ramadani dhe Bislim Bajgora	10,000.00
48532	48022	0411	Zhvillimi Ekonomik	Rregullimi, riparimi i rrugës Mbretëresha Teutë	10,000.00
51733	48022	0411	Zhvillimi Ekonomik	Ndërtimi i Urës te Liqeni Artificial	20,000.00
I ri	48022	0411	Zhvillimi Ekonomik	Fondet e Efijences se Energjise	50,000.00
52916	85022	820	Sherbimet kulturore	Rregullimi i nyjeve sanitare dhe zhveshtores në Palestrën e Sporteve "Minatori"	11,868.25
52928	85022	820	Sherbimet kulturore	Rregullimi i fushave sportive në fshatin Kçiq	3,396.40
					105,264.65

Arsyeshmeria e bartjes: Plani i të hyrave vetanake për buxhetin e vitit 2023 ka qenë në vlerë prej 3,673,370.00 euro ndërsa janë inkasuar të hyra në vlerë prej 4,002,897.55 euro.

Në Komunën e Mitrovicës rezulton se ka tejkalim të planit për të hyrave vetnake për vitin 2023 në vlerë prej 329,527.56 euro.

Bartja e këtyre mjeteve do të bëhet sipas kategorive ekonomike të Ligjit nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

Zyrtar Kryesor Financiar


Adem FAZLIU



Zyrtar Kryesor Administrativ


Bedri HAMZA